



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Clean Life shpk” të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II” me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET PJESËRISHT** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Clean Life shpk” të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II” me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Clean Life shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 07.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II” me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi anikimor 1

Menaxheri i projektit (Lot 1)

Në dosjen e tenderit kërkohet që Operatori Ekonomik të ketë një menaxher projekti i cili duhet të jetë:

- Inxhinier i Mjedisit
- i certifikuar si Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MPMS/MFPT
- i certifikuar për vlerësimin e rreziqeve nga AME
- i certifikuar për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Ky kombinim i kërkesave përbën një kriter të **tejnigarkuar, joproporcional dhe diskriminues**, për arsyt si në vijim:

- Kërkesat për shumëfishim të certifikimeve në fusha të ndryshme profesionale nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e kontratës për pastrim dhe mirëmbajtje.
- Kombinimi i këtyre kualifikimeve në një person të vetëm është jashtëzakonisht i rrallë dhe vështirë i arritshëm në praktikë.
- **Sipas informacionit dhe njohurive nga tregu në Republikën e Kosovës, një profil i tillë është pothuajse unik dhe në praktikë rezulton të jetë i përfaqësuar vetëm nga një operator ekonomik, çka e bën këtë kriter thelbësisht kufizues dhe përjashtues për pjesën dërrmuese të operatorëve ekonomik.**
- Kjo kërkesë nuk ka ndikim proporcional në cilësinë e implementimit të kontratës dhe si e tillë nuk justifikohet nga natyra e shërbimit.

Vendosja e një kriteri të tillë bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë. **Andaj, kërkohet që kjo kërkesë të largohet.**

Pretendimi ankimor 2

KËRKESAT PËR STAF TJETËR (Lot 1 dhe Lot 2)

Kërkesat për:

- ekspert të riskut me certifikime ndërkombëtare dhe përvojë specifike
- menaxher me 7 vite përvojë dhe pagë të përcaktuar
- përgjegjës kontrate me certifikim ISO 31000

janë:

- të paarsyetuara në raport me natyrën e kontratës
- të panevojshme për implementim praktik
- të formuluar në mënyrë që rëndojnë pjesëmarrjen

Këto kërkesa nuk kanë ndikim real në performancën e shërbimit dhe duhet të largohen.

Pretendimi ankimor 3

– PAJISJET (ANEKSI 7 – LOT 1 & LOT 2)

Specifikimet teknike për pajisjet janë formuluar në mënyrë tepër të detajuar dhe kufizuese, duke përfshirë parametra specifik që nuk arsyetohen me nevojat reale të kontratës.

Shembuj konkretë të kufizimeve:

- **“Traktor me lopatë me kapacitet 1123 cm³ dhe fuqi 16KW”**
→ Përcaktimi i saktë i kapacitetit dhe fuqisë është arbitrar dhe nuk ka lidhje me performancën e kërkuar. Çdo pajisje ekuivalente mund të kryejë funksionin.
- **“Makinë për pastrimin e rrugëve me peshë 1800 kg dhe fuqi 11KW”**
→ Kufizimi në peshë dhe fuqi eliminon pajisje të tjera funksionale dhe më efektive.
- **“Kamion me kipper”**
→ Nuk arsyetohet në specifikimet teknike pse kërkohet domosdoshmërisht kjo kategori, kur transporti mund të realizohet me mjete të ndryshme.
- **“Traktor 50KW për kositje”**
→ Nuk justifikohet fuqia fikse, pasi madhësia dhe natyra e sipërfaqeve nuk kërkon standard të tillë rigid.
- **“Tshesë elektrike me bateri minimum 48V”**
→ Kufizim teknik i panevojshëm – pajisje me parametra të ndryshëm mund të ofrojnë performancë të njëjtë.
- **“Rimorkio 750 kg”**
→ Kapaciteti i fiksuar është arbitrar dhe nuk ndikon në cilësinë e shërbimit.
- **“Furgon elektrik 700–900 kg, deri 40KW”**
→ Kjo kërkesë është shumë specifike dhe nuk arsyetohet askund në DT; për më tepër kufizon OE që përdorin automjete konvencionale.

- “Makineri për grirje me fuqi 9KW”
→ Përcaktimi i fuqisë nuk është i domosdoshëm për funksionin.
- “Pajisje për larjen e dritareve mbi 10m”
→ Kjo kërkesë mund të përmbushet me metoda alternative (platforma, shërbime të jashtme), pa kufizuar në pajisje specifike.

Konstatim i përgjithshëm:

- Specifikimet janë bërë në nivel **modeli/parametri**, jo në nivel funksioni
- Nuk është përdorur parimi “ose ekuivalente” në mënyrë efektive
- Kërkesat nuk janë proporcionale me natyrën e kontratës

Këto elemente krijojnë:

- kufizim artificial të konkurrencës
- dyshim për përshtatje ndaj operatorëve të caktuar

Kërkojmë që:

- të hiqen specifikimet e detajuara teknike
- të kërkohej vetëm pajisje sipas funksionit (p.sh. “pajisje për pastrim të jashtëm”)
- të lejohet fleksibilitet për zgjidhje ekuivalente

BAZA LIGJORE

Këto kritere bien ndesh me:

- Nenin 7 të LPP-së (mosdiskriminimi dhe konkurrenca)
- Nenin 27 dhe 28 të LPP-së (specifikimet dhe proporcionaliteti)
- Nenet 51 dhe 69 të LPP-së
- Nenin 17 të Rregullores Nr. 001/2022

PËRFUNDIM

Konsiderojmë se:

- kriteret janë të panevojshme dhe kufizuese
- nuk pasqyrojnë natyrën reale të kontratës
- pengojnë konkurrencën e lirë

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Rishikimin e plotë të kritereve
2. Largimin e kërkesave diskriminuese
3. Hartimin e kritereve proporcionale dhe funksionale

Në të kundërtën, do të ndjekim mjetet juridike të parapara me ligj.

Pretendimi aukimor 4

Ky aktivitet i prokurimi ka dy lote, ku lotin 1 vlera e parshikuar në lot 1 është **2,640,000.00** euro

Duke llogaritur 149 puntor sa janë kërkuar në dosjen e tenderit me pagë 500 bruto + 5% kontribut +18% tvsh për 149 puntor shuma mujore del të jetë **92,305.5** euro. $92,305.5 \times 32$ muaj = **2,953,776.00** euro duke mos llogaritur pushimet vjetore, materialin hixhenik dhe stazhin e punës së puntorëve.

Duke marr parasysh që tejkalohet vlera e parashikuar në lot 1 prej **313,776.00** euro duke mos

Page 3 nga 7

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Ilogaritur materialin higjenik, pushimet vjetore dhe stazhin e puntorëve kërkojm nga ana e juaj sqarim konkret se a keni mjete tjera të planifikuara apo zotuar. Njeherit kërkojm shtimin e mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit pasi që janë të pa mjaftuara.

Pretendimi ankimor 5

Ky aktivitet i prokurimi ka dy lote, ku lotin 2 vlera e parshikuar në lot 2 është **1,506,624.00** euro

Duke Ilogaritur 76 puntor sa janë kërkuar në dosjen e tenderit me pagë 500 bruto + 5% kontribut +18% tvsh për 76 puntor shuma mujore del të jetë **47,082.00** euro. $47,082.00 \times 32$ muaj = **1,506,624.00** euro duke mos Ilogaritur pushimet vjetore, materialin hixhenik dhe stazhin e punës së puntorëve.

Duke marr parasysh që tejkalohet vlerë e parashikuar në lot 2 prej **162,624.00** euro duke mos Ilogaritur materialin higjenik, pushimet vjetore dhe stazhin e puntorëve kërkojm nga ana e juaj sqarim konkret se a keni mjete tjera të planifikuara apo zotuar. Njeherit kërkojm shtimin e mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit pasi që janë të pa mjaftuara.

Kriteret e tilla të pasqyruara në dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike të proklamuar në ANEKS 7 të dosjes së tenderit nuk garanton konkurrenc efektive dhe trajtim të barabart të operatorëve ekonomik dhe janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 28 të LPP-së.

Në këto rrethana struktura apo lista e paisjeve brenda këtyre loteve dhe mënyra e formulimit të kriterëve nuk kontribuojn në rritjen e konkurrencës por kanë efekt kufizues. Andaj kërkojm nga Autoriteti i juaj Kontraktues që ti largoj këto kriterë dhe paisje të cilat janë diskriminuese dhe favorizuese.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kriterëve kualifikuese për OE, ka vendosur kriterë kufizuese të cilat shihen qartë se i'a ka përshtatur një ose disa OE të caktuar. Po ashtu, AK ka vendosur edhe kriterë tjera diskriminuese dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK-së bie ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh me nenin 27, 51 dhe 69 të LPP-së përkatësisht edhe me nenin 17 të RRPP-001/2022.

Këto dispozita flasin qartë dhe i detyrojnë AK-të për mos diskriminimin e OE, për hartimin e kërkesave relevante lidhur me natyrën e lëndës si dhe flasin edhe për natyrën tjetër të kërkesave përkatësisht për hartimin e mirëfilltë të dosjes së tenderit të cilat AK i ka shkelur në mënyrë substanciale.

AK ka vendosur shumë kërkesa të panevojshme të cilat përpos që janë vështirë të arritshme, krijojnë edhe shpenzime materiale për OE ku të njëjtat, më pas do të jenë kosto për vet AK-në pasi që OE ato do të i kalkulojnë të gjitha në çmimin e tenderimit. Aplikimi i komplet kërkesave për, staf dhe mjete pune është në kundërshtim të plotë me praktikën e mira të prokurimit

Mos aplikimi i kriterëve duke u bazuar në natyrën e projektit, përbën favorizim ndaj një OE

AK nuk e ka respektuar këtë andaj konstatojmë se gjatë hartimit të dosjes së

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

tenderit janë shkëlur parimet bazë të prokurimit, neni 27 i LPP-së si dhe neni 17 i RRPP-001/2022

Pra Autoriteti i juaj Kontraktues fare nuk ka arsye që ti vendos ato kritere të cilat nuk vijnë në shprehje në impelmentimin e kontratës.

Kriteret të cilat i kundërshtojm me këtë kërkesë kërkojm që ti largoni pasi që janë diskriminuese pasi nuk pasqyroju me natyrën e projektit.

P.SH. Furgon elektrik me 4 dyer me peshe ngarkuese 700-900 kg, me fuqi deri në 40Kw kjo paisje të cilën e ka cek AK-ja në ANEKS 7 askund të specifikimet teknike nuk e arsyeton përdorimin e saj. Kjo paisje elektrike nuk hyn në funksion dhe ju sigurojn që është kriter vetëm sa për ta rënduar dorzimin e ofertave të OE.Edhe paisjet e tjera si traktorat me kapacitet dhe vëllim të caktuar janë diskriminuese pasi që nuk arsyetohet askund në DT se pse ai kapacitet apo vëllim.

Pra paisjet me të cilat specifikohet vëllimi i caktuar apo kapaciteti i kufizuar janë diskriminuese dhe favorizuese.Mund të jetë p.sh. minimum dhe kubikasha apo maksimumi i kubikazhes apo vëllimi,kapaciteti apo kg por jo të përcaktohet sakt ashtu siç i ka përcaktuar autoriteti i juaj p.sh.

Traktor 50 kw, Rimorkio 750 kg, Makine për pastrimin e rrugëve dhe tortuareve me një brushe me kapacitet ,pasha totale e lejuar 1800 kg,fuqia 11KW, Traktor me lopat dy dyer me kapacitet vëllimi 1123 cm³,fuqia maksimale 16KW, Traktor me lopat dy dyer me kapacitet vëllimi 999 cm³, fuqia maksimale 15KW

Kërkojm edhe një here që të gjitha kriteret e potencuara në pretendimet ankimore ti largoni gjithashtu edhe paisjet ti largoni nga dosja e tenderit siç i kemi kërkuar në pretendimet ankimore.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur si vijon:

AK, fillimisht, ka publikuar edhe formularin për korrigjimin e aktivitetit dhe njëkohësisht ka ofruar sqarimet e nevojshme të kërkuara nga ana e OE-ve të interesuar. Pavarësisht kësaj, OE ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Një qasje e tillë ndihmon AK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njëkohësisht ndihmon në eliminimin e paqartësive eventuale të shfaqura nga palët pas publikimit të njoftimit për kontratë për tenderin me titull "Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve, lot 1 dhe 2". Në këtë bazë, AK refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin si në vijim:

Lidhur me pretendimin e parë apo kërkesën për stafin profesional, ku është kërkuar që menaxheri i projektit duhet të jetë inxhinier i mjedisit me certifikata adekuate për kryerjen e shërbimit, këtu nuk kemi të bëjmë me joproportionalitet siç pretendon OE, por kemi të bëjmë me gjendjen reale apo natyrën e aktivitetit të prokurimit, pasi siç e ka potencuar edhe vetë OE, ky aktivitet është i ndarë në dy lote dhe njëkohësisht përfshin një numër të madh objektesh dhe hapësirash që do të mirëmbahen. Mbi këtë bazë, është e domosdoshme që menaxheri i projektit të ketë përgatitjen e duhur profesionale, përvojën e duhur dhe njëkohësisht të jetë i certifikuar në fushat e kërkuara, në mënyrë që të

realizohet kontrata me profesionalizëm dhe duke shmangur çdo mundësi për ndonjë rrezik eventual. Mbi këtë bazë, pretendimi i parë ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë, e kemi sqaruar edhe më parë se kërkesa e aplikuar në dosje për stafin e kërkuar të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri, minimum 5 punëtorë, është në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe objektin e kontratës që do të realizohet. Mbi këtë bazë, vërehet qartë se kërkesa e vendosur nga AK në dosjen e tenderit është në përputhje të plotë me LPP-në, pasi që është në harmoni të plotë me objektin e kontratës dhe po ashtu nuk ka asnjë pengesë ligjore. I pabazuar është pretendimi ankimor ku thuhet se këto kërkesa nuk kanë ndikim në ofrimin e shërbimeve dhe duhet të hiqen. Ofrimi i shërbimit është i lidhur drejtpërdrejt me profesionalizimin e stafit dhe jo e kundërta, siç pretendon OE. Në një aktivitet prokurimi me vlerë të parashikuar mbi tre milionë euro, është e pamundur të mos fokusohemi te profesionalizimi i stafit dhe njëkohësisht te shërbimi cilësor dhe profesional. Ritheksojmë se të gjitha kriteret janë në harmoni të plotë vetëm me natyrën e aktivitetit të prokurimit, përmes të cilave sigurohet profesionalizimi dhe cilësia sa më e mirë për shërbimin e ofruar. Pra, kërkesat janë të qarta dhe në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Mbi këtë bazë, pretendimi i dytë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë, apo pajisjet teknike të kërkuara tek Aneksi 7, edhe këto kërkesa janë vendosur në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Në kohën e sotme, pa mjete adekuate nuk mund të ofrohet shërbim cilësor. Mbi këtë bazë janë hartuar edhe specifikat teknike për mjetet e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve. Kapaciteti i mjeteve është bazuar në nevojat teknike të objekteve në të cilat do të ofrohet shërbimi dhe nuk ka të bëjë fare me kufizim. Vendosja e kapacitetit motorik apo peshës së mjetit është e bazuar në aspektin teknik të objekteve, pra askund në dosjen e tenderit nuk është e ndaluar ekuivalenca, siç pretendon OE në kërkesën për rishqyrtim. Ritheksojmë se mjetet e specifikuara tek Aneksi 7 i dosjes së tenderit janë minimumi i mundshëm për realizimin e shërbimit që duhet të posedojë kompania pretendente për ofrimin e shërbimit. Arsyeimi i përdorur nga OE se këto janë të panevojshme është tepër i pabazuar, për faktin se OE nuk është duke zhvilluar aktivitet prokurimi për kompaninë e tij, por pretendon të marrë pjesë në ofrimin e shërbimit tek një autoritet kontraktues. Po ashtu, është për t'u habitur fakti se si specifikohen nevojat e AK-së nga një OE që pretendon të ofrojë shërbime. Ritheksojmë se asnjë nga pajisjet e kërkuara tek Aneksi 7 nuk është jashtë natyrës së aktivitetit të prokurimit dhe nuk bie ndesh me nenin 69 të LPP-së; përkundrazi, pajisjet e kërkuara janë vetëm minimumi përmes të cilit mund të ofrohet shërbim sa më cilësor. Pavarsisht spjegimit të lartcekur për shkak të një gabimi teknik për pozicionet 7 dhe 8 traktor lejohet vëllimi prej 900cm³ deri në 1000cm³ fuqia maksimale 15KW dhe për pozicionin 8 vëllimi lejohet nga 1000cm³ deri në 1150cm³ fuqia maksimale 16kw. Mbi këto baze aprovohet si pjesërisht i bazuar pretendimi ankimor për pajisje.

Lidhur me pretendimet ankimore rreth vlerës së parashikuar, të shprehura në pikat 4 dhe 5, vlera e parashikuar është e bazuar në vlerën aktuale të tregut. Njëkohësisht, procedura është e hapur dhe po ashtu kriteri i dhënies së kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në fazën në të cilën gjendet procedura, është hipotetike të thuhet se vlera e parashikuar është e ulët; një gjë e tillë do të vërtetohet pas hapjes së ofertave të

mundshme, për të cilat jemi të bindur se vlera është reale dhe e bazuar në tregun aktual të ofrimit të shërbimit të kërkuar. Mbi këtë bazë, pretendimi ankimor është i pabazuar. Si përfundim, AK ka publikuar njoftimin mbi korrigjimin e aktivitetit të prokurimit, ku ka vërejtur gabime teknike të shfaqura në dosjen e tenderit. Po ashtu, kriteret janë të vendosura në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit që është publikuar, duke marrë për bazë parimet e prokurimit, nenin 7 për mosdiskriminimin dhe nenin 6 për ekonomicitetin dhe efikasitetin e procedurës.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Megjithatë kërkesa për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar vetëm sa i përket pikës për peshën e traktorit ndërsa pjesa tjetër është refuzuar si e pabazuar. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.